



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-016
Prishtinë, më 30 mars 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 30 MARS 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati, dhe

Nga KDI-ja: Driton Selmani.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryetari, në fillim i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se nga mbledhja e ardhshme e Kryesisë së Kuvendit, të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët shprehin interesim, mund të marrin pjesë në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër (4) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 mars 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave,
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 mars 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 23 mars 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari fillimisht i njoftoi anëtarët e Kryesisë se kanë mbetur edhe tri (3) pika të papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 26 dhe 27 mars 2015.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikat e papërfunduara të seancës së mëparshme, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të enjten, më 2 prill 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar për Radiotelevizionin e Kosovës,*
2. *Zgjedhja e Avokatit të Popullit,*
3. *Votimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.*

Kryesia, pas diskutimit propozim-rezolutën e Grupit Parlamentar të PDK-së për të vënë drejtësi për gjenocidin dhe krimet e luftës të kryera nga Serbia ndaj popullsisë së Kosovës, dëmet e luftës të shkaktuara ndaj popullit dhe pasurisë së Kosovës, si dhe për ta zbardhur fatin e personave të zhdukur gjatë luftës e shtyu për shqyrtim në njërin nga mbledhjet e radhës së Kryesisë.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 2 prill 2015, në orën 14:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës,*
4. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-09 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike,*
5. *Shqyrtimi i rekomandimit për transferimin e mjeteve nga buxheti i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës në Buxhetin e Komunës së Gjakovës për vitin 2015,*
6. *Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,*
7. *Debat parlamentar lidhur me punën 100-ditëshe të kryeministrit Isa Mustafa dhe Programin Qeverisës, sipas kërkesës së deputetit Glauk Konjufca, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë,*
8. *Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me petitionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike.*

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

1. *Rekomandimi i Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me Peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e lartshënuar, këtë çështje e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës, që do të mbahet më 2 prill 2015.

2. *Kërkesa e deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Ministria e Shëndetësisë që ta përgatisin një informatë lidhur me gjendjen e arsimit në Luginë të Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë të tjerë.

2. Informata e kërkuar duhet të përgatitet dhe të procedohet në Kuvend, para se Kuvendi të debatohet lidhur me këtë çështje.

3. Kërkesa e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në këtë përbërje: Albulena Haxhiu, Agim Aliu, Armend Zemaj, Donika Kada-Bujupi dhe Danush Ademi, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Visar Krasniqi, dhe një vozitësi, në Shqipëri, prej datës 2-3 prill 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

4. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian për vizitën zyrtare të realizuar në Beograd, prej 10-11 mars 2015

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të realizuar nga Komisioni për Integritet Evropian në Beograd, prej 10-11 mars 2015.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Itali

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Teuta Sahatqija, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Ilir Deda në Itali, prej datës 7-9 prill 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e kësaj vizite zyrtare për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Kërkesë për lejimin e udhëtimit të delegacionit në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputetja e Kuvendit Blerta Deliu-Kodra caktohet që të marrë pjesë në takimin e parë të Komisionit të Përhershëm të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, si dhe zyrtarja nga Protokolli i Administratës së Kuvendit, Merita Drenori, i cili do të mbahet në Shqipëri, prej datës prej 16-18 prill 2015.

2. Shpenzimet e akomodimit për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi do të mbulohen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ndërsa shpenzimet e transportit, mëditjet shtesë, si dhe të gjitha shpenzimet për një vozitës mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3. Kërkesa për mbulimin e shpenzimeve për anëtarët e Komisionit për Edukim, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Shqipërisë që do ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës më 16-17 prill 2015

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës të Komisionit Parlamentar për Edukim, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në Kuvendin e Kosovës, prej 16-17 prill 2015.
2. Të gjitha shpenzimet e dala me rastin e pritjes së delegacionit të cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të ndryshme:

1. Nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, e shtroi çështjen e teknikës së votimit dhe të zërimit në Kuvend

Nënkryetari tha se Kuvendi e ka një teknik jo të mirë për mënyrën e votimit, veçanërisht të votimit të fshehtë dhe kërkoi që të bëhet edhe votimi i fshehtë elektronik. Gjithashtu, ai propozoi që pasi nuk ka ndonjë donacion për rregullimin e kësaj çështjeje, është mirë që me buxhetin e Kuvendit të shihet mundësia për blerjen e teknikës përkatëse elektronike të votimit dhe zërimit në Kuvend.

Kryetari tha se për çështjen e shtruar nga nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, duhet të pritët edhe pak, përkatësisht të shihet mundësia e gjetjes së ndonjë donatori që do ta mbështeste këtë program.

2. Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, e shtroi çështjen e procedimit të Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të Projekt-Rregullores së Kuvendit

Nënkryetari tha se këto drafte, që janë hartuar nga ekspertët e Projektit të Binjakëzimit për mbështetje Kuvendit të Kosovës, ekzistojnë dhe janë mjaft të mira për t'i proceduar për shqyrtim në Kuvend. Këto dy akte, me Programin e punës së Kuvendit, janë paraparë që të procedohen për shqyrtim në Sesionin vjeshtor, por do të kishte qenë mirë, për shkak të rëndësisë që kanë, të procedohen gjatë Sesionit pranveror.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamiti, nxori këtë:

Përfundim

Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si komision funksional, që ta hartojë dhe procedojn Projektligjin për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Projekt-Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesë për shqyrtim dhe miratim gjatë Sesionit pranveror.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale